



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

UDHËZIM

Nr. 03, Datë 11.02.2015

Për

**“Procedurën e konkurrimit të kandidatëve për prokurorë që kanë punuar gjyqtarë, prokurorë ose oficerë të Policisë Gjyqësore”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, gërma "gj" dhe nenit 20 të ligjit nr. 8737 datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar);

Pasi u mor mendimi i Këshillit të Prokurorisë;

UDHËZOJ:

KREU I

SHPALLJA E VENDEVE VAKANTE

Neni 1

Shpallja e vendeve vakant

1. Me krijimin e vendeve vakante për prokurorë, Prokurori i Përgjithshëm urdhëron shpalljen publike në të paktën dy gazeta me shpërndarje kombëtare dhe tirazh të lartë, si dhe në Radio Televizionin Publik.

2. Shpallja duhet të përcaktojë detyrimisht:

- a. Prokurorinë në të cilën është krijuar vendi/et vakante;
- b. Dokumentet e kërkuara për përmbushjen e kriterëve ligjore të kandidatëve për t'u pranuar në konkurrimin për prokuror;
- c. Datën e konkurrimit, e cila caktohet të paktën 40 ditë pas datës së shpalljes.

## **Neni 2**

### **Depozitimi i kërkesave**

1. Depozitimi i kërkesave, të shoqëruara me dokumentet e kërkuara për pranimin në konkurrim, duhet të bëhet nga konkurruesit jo më vonë se dy javë nga data e shpalljes publike të vendit vakant.
2. Kërkesat depozitohen pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

## **KREU II**

### **VERIFIKIMI I DOKUMENTACIONIT DHE ORGANIZIMI I KONKURISIT**

## **Neni 3**

### **Organizimi i konkursit**

1. Konkursi për emërimin prokurorë, për kandidatët që kanë punuar gjyqtarë, prokurorë ose oficerë të Policisë Gjyqësore, organizohet nga Këshilli i Prokurorisë, në përputhje me Rregulloren nr.79, datë 16.04.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Prokurorisë” e ndryshuar dhe me këtë udhëzim.
2. Komisioni dhe procedura e verifikimit të përmbushjes së kriterëve ligjore të kandidatëve për t’u emëruar prokuror janë të njëjtë me atë të vendosur në përputhje me nenet 3 dhe 3/a të Rregullores nr.79, datë 16.04.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Prokurorisë”, e ndryshuar.
3. Këshilli i Prokurorisë, vlerëson relacionin e Komisionit të Verifikimit të Dokumentacionit brenda 5 ditëve nga marrja e tij dhe kur ka kandidatura që plotësojnë kriteret ligjore për t’u emëruar prokuror, i propozon Prokurorit të Përgjithshëm ngritjen e Komisionit të Testimit të Kandidatëve.
4. Komisioni i Testimit të Kandidatëve përbëhet nga:
  - a. 1 (një) prokuror që ushtron funksionet pranë Prokurorisë së Përgjithshme;
  - b. 1 (një) prokuror që ushtron funksionet në prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë;
  - c. 1 pedagog i të Drejtës Penale dhe/ose Procedure Penale në Shkollën e Magjistraturës.
5. Këshilli dhe Komisionet ndihmohen nga administrata e Prokurorisë së Përgjithshme.
6. Personat që marrin pjesë në procedurën konkurruese nuk duhet të jenë në kushtet e konfliktit të interesave me kandidatët që konkurojnë për prokuror.

## **Neni 4**

### **Njoftimi i kandidatëve për testim**

1. Këshilli i Prokurorisë shpall listën e kandidatëve që përmbushin kriteret ligjore për t’u emëruar prokurorë dhe të kandidatëve që nuk i plotësojnë këto kriterë.

2. Këshilli i Prokurorisë njofton kandidatët që plotësojnë kriteret ligjore për t'u emëruar prokurorë, për vendin dhe kohën e kryerjes së testimit, të paktën 10 ditë përpara.

### **KREU III RREGULLAT E KONKURRIMIT**

#### **Neni 5 Vlerësimi i testimit**

1. Konkurrimi kryhet në dy faza, me shkrim nga Komisioni i Testimit dhe seancë dëgjimore nga Këshilli i Prokurorisë. Në rast se numri i kandidatëve është i lartë Këshilli i Prokurorisë, vendos të shtyjë seancën dëgjimore në një ditë tjetër.

2. Vlerësimi i testimit (me shkrim dhe seanca dëgjimore) është maksimumi 100 pikë.

3. Vlerësimi për testimin me shkrim është maksimumi 75 pikë. Vlerësimi për seancën dëgjimore është maksimumi 25 pikë.

4. Kandidati kualifikohet për të vijuar procedurën konkurruese nëse në përfundim të testimit me shkrim ka marrë minimumi 45 pikë.

#### **Neni 6 Përgatitja e tezave**

1. Kandidatët testohen me shkrim mbështetur në tezat e përgatitura nga Komisioni i Testimit.

2. Teza e cila është e njëjtë për të gjithë, përmban:

a. dy pyetje teorike që testojnë njohuritë që kandidatët kanë për legjislacionin, për marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në fushën penale dhe procedurale penale, si dhe për praktikën gjyqësore, të përfshira në Aneksin Nr. 1, bashkëlidhur udhëzimit.

b. dy raste praktike, të përzgjedhura nga vendimet e Kolegjeve Penale të Gjykatës së Lartë.

3. Tërheqja e tezës me pyetjet teorike dhe rastet praktike do të bëhet nga vetë kandidatët.

4. Çdo pyetje e tezës vlerësohet me pikë sipas tabelës në fund të testit.

#### **Neni 7 Detyrimet e konkurruesve**

1. Ditën e testimit kandidatët duhet të kenë me vete vetëm dokumentin e identifikimit. Materialet për zhvillimin e testimit sigurohen nga administrata e Prokurorisë së Përgjithshme.

2. Koha në dispozicion të zgjidhjes së tezave është deri në 3 orë.

3. Para fillimit të testimit kandidatëve u bëhet e ditur se:

a. ndalohet përdorimi dhe mbajtja e telefonave celular dhe e paisjeve të tjera.

- b. nuk duhet të flasin ose të japin e marrin asistencë/ndihmë nga njeri – tjetri apo nga persona të tjerë gjatë provimit, për asnjë lloj arsyeje;
  - c. nuk duhet të shkruajnë emrin apo vendosin shenja në fletët e provimit.
4. Shkelja e këtyre rregullave nga kandidati dokumentohet me procesverbalin përkatës dhe përbën shkak për përjashtimin nga konkurrimi dhe/ose deklarinimin e testimin të tij të pavlefshëm nga Komisioni i Testimit.

## **Neni 8**

### **Sekretimi, administrimi dhe ruajtja e materialeve të testimin**

1. Fletët e përgjigjeve të testimin me shkrim vulozen para se t'u shpërndahen konkurruesve.

2. Të gjithë konkurruesve u jepet një zarf dhe një fletë, në të cilën kandidati do të shkruaj emrin e tij. Letra futet në zarf dhe zarfi mbyllet nga kandidati. Zarfi i mbyllur do të vulozet nga punonjësi i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, anëtar i Komisionit të verifikimit të Dokumentacionit.

3. Në fund të testimin kandidati dorëzon zarfin së bashku me fletët e testimin në vendin e caktuar. Punonjësi i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, anëtar i Komisionit të verifikimit të Dokumentacionit, vendosë të njëjtin numër si në zarf ashtu dhe në fletën e testimin me shkrim të çdo konkurruesi.

4. Pas vendosjes së numrave dhe të vulave, të gjitha fletët e testimin me shkrim kontrollohen nga monitorët nëse kanë shenja apo emra. Në rast se konstatohen shenja të ndryshme në fletët e testeve, monitoruesit mbajnë procesverbal me kandidatin për të dokumentuar faktin, i cili bashkë me fletët e testimin i dorëzohet Komisionit të Testimit, që vendosë për shpalljen të pavlefshme.

5. Fletët e vlefshme të testimin vendosen në një kuti kasafortë të vulosur. Zarfat e numërtuar që përbajnë emrat futen në një zarf të veçantë, i cili mbyllet dhe vulozet.

6. Kutia kasafortë e vulosur i vihet në dispozicion Komisionit të Testimit ndërsa zarfi me emrat e pjesëmarrësve ruhet në një ambient të siguruar në Prokurorinë e Përgjithshme.

## **Neni 9**

### **Monitorimi**

1. Gjatë testimin me shkrim ambienti/salla mbikëqyret me kamera dhe nga persona të caktuar brenda administratës së prokurorisë.

## **Neni 10**

### **Korrigjimi i testeve**

1. Kutia me fletët e testimin hapet në prezencë të Komisionit të Testimit.
2. Komisionit i vihet në dispozicion vetëm fleta e provimit me një numër të caktuar.

3. Korrigjimi i testeve me shkrim do të bëhet brenda godinës së Prokurorisë së Përgjithshme. Asnjë anëtar i Komisionit nuk lejohet që të marrë me vete fletët e provimit.

4. Pas korrigjimit të testeve, në prani të Komisionit anëtarët e Këshillit të Prokurorisë hapin zarfin, ku ndodhen zarfat e numërtuar që përmbajnë emrat e kandidatëve.

## **Neni 11** **Vlerësimi**

1. Këshilli i Prokurorisë organizon seancën dëgjimore të kandidatëve në mënyrë të tillë që të marrë informacion mbi formimin, përvojat e punës dhe objektivat e tij.

2. Këshilli i Prokurorisë bën renditjen e kandidatëve të kualifikuar bazuar në rezultatin me shkrim dhe seancën dëgjimore.

3. Rezultatet e konkurrimit u njoftohen kandidatëve.

4. Këshilli i Prokurorisë, mendimin e tij për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, ia paraqet Prokurorit të Përgjithshëm.

5. Kandidatët e kualifikuar që nuk shpallen fitues për vendin/vendet vakante, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë dhe të mos i nënshtrohen testimi me shkrim, për vende vakante për prokurororë të shpallura brenda dy vjetësh nga data e konkurrimit.

## **Neni 12** **Dispozitë zbatuese**

1. Ngarkohet Këshilli i Prokurorisë për kontrollin dhe zbatimin e këtij udhëzimi, i mbështetur nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore dhe Sekretari i Përgjithshëm.

2. Ngarkohet punonjësi i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, anëtar i Komisionit të Verifikimit të Dokumentacionit, me kryerjen e veprimtarisë administrative të nevojshme për zbatimin e këtij udhëzimi.

3. Ngarkohen Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore të marrin të gjitha masat e duhura organizative për zbatimin e këtij udhëzimi.

4. Ngarkohen Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrin të gjitha masat e duhura mbështetëse dhe financiare për të siguruar zbatimin e këtij udhëzimi dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit të Testimit të Kandidatëve, sipas tarifave të përcaktuara me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

## **Neni 13**

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**PROKUROR I PËRGJITHSHËM**

ADRIATIK LLALLA



## ANEKSI NR.1

### **1. Testimi për njohuritë teorike që kandidatët duhet të kenë për legjislacionin, përfshijnë njohuritë për:**

- i. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- ii. Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;
- iii. Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- iv. Ligjin 9754/2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridik”;
- v. Ligjin 8331/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” , i ndryshuar;
- vi. Ligjin 8328/1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”;
- vii. Ligjin 10182/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”
- viii. Ligjin 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” , i ndryshuar;
- ix. Ligjin 10173/2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, i ndryshuar;
- x. Ligjin 10193/2009 “Për marrdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar;
- xi. Ligjin 8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” , i ndryshuar;
- xii. Kodin e Etikës së Prokurorit;
- xiii. Ligjin 8677/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” , i ndryshuar;
- xiv. Ligjin 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” , i ndryshuar;
- xv. Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda”;
- xvi. Ligjin 108/2014 “Për policinë e shtetit”;
- xvii. Ligjin 8136/1996 “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” , i ndryshuar;
- xviii. Ligjin 9109/2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” , i ndryshuar;
- xix. Ligjin 10018/2008 “Për Avokaturen e Shtetit”;
- xx. Ligjin 8730/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”;
- xxi. Ligjin 7830/1994 “Për Autopsitë”;
- xxii. Ligjin 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- xxiii. Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- xxiv. Ligjin 8750/2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike dhe psikotrope” i ndryshuar;
- xxv. Ligje të tjera që lidhen me veprimtarinë procedurale penale të tyre;

**2. Testimi për njohuritë teorike që kandidatët duhet të kenë për aktet ndërkombëtare të ratifikuara/aderuara në fushën penale dhe procedurale, përfshijnë njohuritë për:**

- i. Konventën Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe Protokollet e saj, ratifikuar me ligjin Nr. 8137 datë 31. 07. 1996, FZ Nr.20, viti 1996, fq. 724;
- ii. Konventën Europiane “Për parandalimin e torturës dhe të trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor dhe degradues”, aderuar me ligjin Nr. 8135, datë 31. 07. 1996, FZ, Nr.20, viti 1996, fq. 723;
- iii. Konventën e Kombeve të Bashkuara “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy Protokollet shtesë të saj, ratifikuar me ligjin Nr. 8920 datë 11. 07. 2002, FZ Nr. 41, viti 2002, fq. 1195;
- iv. Konventën e Kombeve të Bashkuara “Kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope”, aderuar me ligjin Nr. 8722 datë 26. 12. 2000, FZ. Nr. 50 viti 2000, fq. 2156;
- v. Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për substancat psikotrope”, aderuar me ligjin Nr. 8965, datë 7. 11. 2002, FZ, Nr.79, viti 2002, fq. 2254;
- vi. Konventën Penale “Për korrupsionin”, ratifikuar me ligjin Nr. 8778 datë 26. 04. 2001, FZ. Nr. 24 viti 2001, fq. 742;
- vii. Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për luftën kundër financimit të terrorizmit”, ratifikuar me ligjin Nr. 8865 datë 14. 03. 2002, FZ. Nr. 7 viti 2002, fq. 170;
- viii. Konventën Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”, ratifikuar me ligjin Nr. 8646 datë 20. 07. 2000, FZ Nr. 23, viti 2000, fq. 1183;
- ix. Konventën e Këshillit të Europës “Për ekstradimin” dhe dy Protokollet shtesë të saj, ratifikuar me ligjin Nr. 8322 datë 2. 04. 1998, FZ. Nr.10 viti 1998, fq. 353;
- x. Konventën e Këshillit të Europës “Për transferimin e procedimeve penale”, ratifikuar 8497 datë 10. 06. 1999, FZ. Nr. 21, viti 1999, fq. 681;
- xi. Konventën e Këshillit të Europës “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale” dhe Protokollin e dytë shtesë të saj, ratifikuar me ligjin Nr. 8498 datë 10. 06. 1999, FZ. Nr.21 viti 1999, fq. 697;
- xii. Konventën e Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar”, ratifikuar me ligjin Nr. 8499 datë 10. 06. 1999, FZ. Nr.22 viti 1999, fq. 719;
- xiii. Konventën Europiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar dhe të liruar me kusht”, ratifikuar me ligjin Nr. 8724 datë 26. 12. 2000, FZ. Nr. 50 viti 2000, fq. 2234;

**3. Testimi për njohuritë teorike që kandidatët duhet të kenë për praktikën gjyqësore, përfshijnë njohuritë për:**

- i. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese në fushën penale dhe procedurale penale;
- ii. Vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në fushën penale dhe procedurale penale;
- iii. Vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.